




UNIVERSITETI I  
PRISHTINËS "HASAN  
PRISHTINA"

**2024 - 2028**

# PLANI STRATEGJIK

Fakulteti I Inxhinierisë së Ndërtimit





# UNIVERSITETI I PRISHTINËS

## “HASAN PRISHTINA”

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

# PLANI

## STRATEGJIK

2024-2028



*Prishtinë, 2023*



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT  
Plani Strategjik 2024 – 2028

## PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	1
2. HYRJE .....	3
2.1. Historiku .....	4
2.2. Misioni dhe Vizioni .....	5
3. METODOLOGJIA .....	6
4. ANALIZË E GJENDJES AKTUALE .....	7
4.1. Struktura organizative e FIN-it.....	7
4.2. Programet e Studimit .....	7
4.3. Infrastruktura dhe Burimet .....	9
4.4. Cilësia dhe Akreditimi .....	12
5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE.....	13
5.1. Objektivi Strategjik 1: Ngritja e Cilësisë në Mësimdhënie dhe Mësimnxënie .....	13
5.2. Objektivi Strategjik 2: Avancimi i Shkencës, Inovacionit dhe Ndërlidhja me Tregun e Punës.....	18
5.3. Objektivi Strategjik 3: Përmirësimi i Pozicionit dhe Rolit të FIN në Skenën Ndërkombëtare.....	21
6. ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	24
7. NDIKIMI BUXHETOR I STRATEGJISË .....	25

## SHKURTESAT

BSc	Bachelor Shkencor
ENQA	European Association for Quality Assurance in Higher Education
FIM	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
FIN	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
NjA	Njësia Akadematike
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MIRU	Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore
MSc	Master Shkencor
UP	Universiteti i Prishtinës, “Hasan Prishtina”
ZZHA	Zyra për Zhvillim Akademik
IAL	Institucioni i Arsimit të Lartë

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, sipas Planit Strategjik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” 2023 – 2025, si dhe mbështetur në Strategjinë e Arsimit 2022-2026, plani i veprimit, harton Planin Strategjik të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN) për periudhën 2024 – 2028.

Duke synuar rritjen e vazhdueshme të cilësisë së arsimit të lartë si dhe krijimin dhe ngritjen e kapaciteteve, FIN harton synimet për arritjen e qëllimeve strategjike, dhe objektive të veçanta të përcjellura me plane të veprimeve të cilat përbajnë aktivitete konkrete me qëllim arritjen e këtyre synimeve.

Për të realizuar synimet institucionale, IAL përcakton prioritetet e saj, duke u mbështetur në resurset akademike, financat dhe logjistikën. Synimi i arritjes së qëllimeve strategjike nga parimi i kapaciteteve të resurseve lehtëson progresin e punës dhe aktiviteteve të menaxhuara në mënyrë adekuate dhe të përgjegjshme. Synimet e strategjisë së FIN-it për arritje të qëllimeve për periudhën katër vjeçare 2024 deri 2028 përcaktohen edhe si detyra me prioritet për menaxhmentin, stafin akademik dhe administrativ të IAL-së, e të cilat janë:

- Rritja e performancës së FIN-it, respektivisht stafit akademik në mënyrë kualitative dhe kuantitative. Hulumtimet shkencore, përsosja e programeve të studimeve, shërbimet e administratës, hapësirat e ambienteve të mësimin, digjitalizimit, si varësi dhe tregues të performancës së IAL-së.
- Promovimi dhe zbatimi i standardeve të niveleve bashkëkohore për aktivitetet akademike në mësimdhënie dhe mësimnxënie.
- Avancimi shkencor përmes komponentës akademike dhe hulumtuese, nxitja e inovacionit, aktualizimi i kërkesave të dala nga tregu i punës lidhur me nevojat e tyre në kohë reale.
- Organizimi i konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, konferencave atudentore, punëtorive për temat dhe problematikat aktuale të fushave të inxhinierisë së ndërtimit. Kjo motivon stafin akademik dhe studentët për rritjen e aktiviteteve për realizimin e hulumtimeve shkencore. FIN do të jetë aktiv duke marrur edhe rolin e bartësit dhe të organizatorit.
- Marrëveshjet me IAL-të ndërkombëtare, bashkëpunimet e veçanta lidhur me zhvillimin e programeve studimore, projekteve ndërkombëtare (HERAS, ERASMUS +, etj.), bashkëpunimet direkte me Universitetet Evropiane, projektet ndërkombëtare hulumtuese janë vazhdueshmëri e FIN-it.

- Bashkëpunimi i IAL-së me institucione vendore, subjekte nga tregu i punës me qëllim të krijimit të mundësive të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve, zhvillimit të ligjëratave të hapura me tematika shkencore dhe praktikave profesionale, trajnimet e ndryshme për stafin akademik, studentët dhe administratën, determinojnë diversitetin akademik të IAL-së dhe fokusi i menaxhmentit të FIN do të paraqes si interes të veçantë të zhvillimit.
- Ngritja e pozitës dhe rolit ndërkombëtar të Universitetit të Prishtinës përmes programeve arsimore bashkëpunuese, rritjes së përfshirjes në nismat ndërkombëtare bashkëpunuese akademike dhe hulumtuese nga FIN.

Duke vlerësuar gjendjen jo të mirë të ambienteve të mësimi, hapësirave të laboratorëve, pajisjeve laboratorike, sallave të leximit, sallave të TI-së, korridoret si dhe ambientet përcjellëse të FIN, në këtë periudhë kohore do të jetë synim i menaxhmentit rritja e performancës së tyre duke u mbështetur nga UP-ja.

Dokumenti në vijim paraqet qartazi planifikimin e paraparë nga institucioni në arritjen e këtyre objektivave.

## 2. HYRJE

Plani strategjik i FIN për periudhën 2024–2028 synon të përcaktojë komponentët, drejtimin dhe objektivat kryesore të zhvillimit të Fakultetit, rritjes së performancës së stafit akademik, rritjes së cilësisë së mësimnxënies të studentëve, rritjes së cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimeve për studentët. Ky zhvillim do të jetë i bazuar në kapacitetet Institucionale të UP-së dhe të FIN, punën kreative të menaxhmentit, gjithëpërfshirjen e stafit akademik në projektet hulumtuese shkencore, shërbimet institucionale, ekspertizat dhe eksperiencën, gjithnjë duke përfshirë studentët.

Plani strategjik i institucionit do të jetë një dokument orientues i zhvillimit që do të përcaktojë rritjen e kapaciteteve të veprimtarive të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, gjithnjë duke përmbushur misionin dhe vizionin e tij në mënyrë efektive gjatë periudhës katër vjeçare.

Ky plan është produkt i një pune të vazhdueshme dhe konsultimeve me pjesëmarrësit e ndryshëm, përfshirë stafin akademik, administratën, studentët, alumni (të diplomuarit), mbështetësit dhe bashkëpunëtorët.

Kjo qasje e përfshirjes të të gjitha palëve ndihmon në sigurimin e një vizioni të përbashkët dhe në identifikimin e mënyrave për të arritur objektivat e përcaktuara.

Hartimi i plani strategjik të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit mbështetet në Statutin e UP-së, Rregulloret përkatëse të Institucionit, Strategjinë e Universitetit të Prishtinës si dhe dokumente relevante të cilat rregullojnë funksionimin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP) siç janë:

- 1) Statuti i UP-së, si një dokument themelor që rregullon strukturën e Universitetit, kompetencat dhe funksionet e organeve të tij drejtuese, dhe të drejtat dhe detyrat e të gjithë palëve të përfshira në universitet.
- 2) Plani Strategjik i UP-së, si një dokument bazë për të siguruar përputhjen e qëllimeve dhe objektivave të fakultetit me ato të universitetit.
- 3) Aktet normative dhe ligjore të Republikës së Kosovës që kanë ndikim në funksionimin e Fakultetit dhe Universitetit në përgjithësi, përfshirë ligjet për arsimin e lartë.
- 4) Rregulloret e brendshme të Universitetit dhe Fakultetit që përcaktojnë procedurat dhe politikatat e tyre të veçanta.

Zhvillimi, Orientimi, Misioni dhe Vizioni i Planit Strategjik të FIN i bazuar në dokumentet e më sipërme siguron që Njësia akademike të funksionojë në përputhje me standardet e larta të

qeverisjes Universitare duke përfshirë të drejtat dhe detyrat e të gjithë pjesëmarrësve të njësisë akademike.

## **2.1. Historiku**

Historia e Fakultetit të Inxhinerisë së Ndërtimit në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" shënon një periudhë të rëndësishme në zhvillimin e shkencave teknike në Kosovë.

Fakulteti i Inxhinerisë së Ndërtimit ka rrënjët e tij në hapjen e Shkollës së Lartë Teknike dhe ka kaluar nëpër zhvillime të ndryshme për të arritur në fazën e tij të tanishme si një institucion i pavarur të arsimit të lartë.

Momentet kyçe të historisë së Fakultetit të Inxhinerisë së Ndërtimit janë:

- Në 20 tetor 1961, Shkolla e Lartë Teknike e Prishtinës u hap dhe filloi të ofronte mësim në tre drejtime teknike, përfshirë Ndërtimtarinë, Elektroteknikën dhe Makinerinë. Ky hap ishte një moment themelor në ndërtimin e shkencave teknike në Kosovë.
- Në 9 nëntor 1965, u hap Departamenti i Ndërtimtarisë brenda Shkollës Teknike të Prishtinës. Mësimi në departamentin e Ndërtimtarisë filloi më 10 dhjetor të të njëjtit vit. Ky ishte një hap i rëndësishëm që shënoi fillimin e programeve të studimit të ndërtimtarisë në nivelin e lartë në Kosovë, me një numër prej 138 studentësh dhe një staf akademik me pesë ligjërues dhe pesë asistentë.
- Në vitin 1979, Fakulteti Teknik u formua nga disa fakultete, përfshirë Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, duke konsoliduar dhe zgjeruar gamën e programeve të ofruara nga fakulteti. Kjo solli përmirësimin e infrastrukturës dhe kapaciteteve të studimit.
- Në vitin 2002, programet e studimeve u reformuan për të përmbushur standardet e deklaratës së Bolonjës. Ky ishte një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit të lartë në fakultet.
- Në vitin akademik 2019-2020, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Fakulteti i Arkitekturës u bënë institucione të pavarura të arsimit të lartë, duke treguar zhvillimin e tyre të pavarur dhe rritjen e rëndësisë së fushës së ndërtimtarisë dhe arkitekturës në arsimin e lartë në Kosovë.
- Në vitin akademik 2022-2023, emri i Fakultetit të Ndërtimtarisë është ndryshuar në "Fakultetin e Inxhinerisë së Ndërtimit" duke respektuar të gjitha rregulloret dhe procedurat për ndryshimin e emrit të një institucioni të arsimit të lartë dhe duke siguruar mbështetjen dhe miratimin e nevojshëm për këtë ndryshim. Ky ndryshim është bërë për të pasqyruar më mirë fushën e studimeve dhe profesionet që ofrohen nga ky fakultet.



## 2.2. Misioni dhe Vizioni

### Misioni i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit:

- Oferta e programeve të studimeve cilësore në nivelin Baçelor dhe Master në fushën e inxhinierisë së ndërtimit për brezat e rinj të vendit mbështetur në kërkesat e tregut të punës.
- Përgatitja e kuadrove - studentëve me shkathësi, njohuri dhe aftësi të thella të fushave të Inxhinierisë së Ndërtimit duke përfshirë konstruksione, gjeodezi, hidroteknikë, inxhinieri e ambientit, dhe menaxhim i integruar i resurseve ujore.
- Promovimi i përdorimit të të arriturave shkencore bashkëkohore, përdorimit të teknologjive të reja dhe inovacioneve të fushave në inxhinierinë e ndërtimit.
- Zhvillimi i hulumtimeve shkencore në fushën e inxhinierisë së ndërtimit përmes aktivizimit të stafit akademik, studentëve në projektet shkencore në nivel vendi dhe ndërkombëtar.
- Kontributi shkencor dhe profesional i stafit akademik të cilësuar si ekspert vendor në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit duke përfshirë studentët për nevojat Institucionale dhe të tregut të punës.
- Përfshirja e tregut të punës në nevojat IAL-së, duke kontribuar në përsosjen e programeve të studimeve.

### Vizioni i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit:

- FIN të jetë një qendër e shquar e arsimit të inxhinierisë së ndërtimit në Kosovë duke u njohur ndërkombëtarisht për programet e studimeve, cilësinë e arsimit dhe kontributin Institucional në zhvillimin e qëndrueshëm të fushës së inxhinierisë së ndërtimit.
- Shkalla e fleksibilitetit dhe shpejtësia e përshtatshmërisë së programeve të studimeve sipas nevojave dhe kërkesave të tregut të punës duke siguruar cilësi të lartë në të gjitha aktivitetet akademike, hulumtime, mësimdhënie si dhe shërbimeve tjera të kërkuara nga institucionet vendore.
- Punë kërkimore dhe akademike të mësimdhënësve dhe studentëve për të mbështetur procesin e mësimdhënies cilësore, vlerësimeve bashkëkohorë, mësimnxënies, si procese të vazhdueshme Institucionale.
- Krijimi i kushteve dhe mundësive të pa penguara për zhvillimin dhe avancimin e aktiviteteve akademike për mësimdhënie të avancuar dhe hulumtime shkencore të stafit akademik.

- Angazhim aktiv i studentëve si në aspektin individual ashtu edhe kolektiv në jetën e aktiviteteve të Fakultetit, përkatësisht zhvillimit të programeve të studimeve dhe në mësimnxënien e tyre.
- Zhvillimi dhe avancimi i programeve të studimeve të fushave të Ndërtimtarisë, përkatësisht të Konstruksioneve, Gjeodezisë, Hidroteknikës, Inxhinierisë së Ambientit dhe Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore, duke u mbështetur në arritjet shkencore dhe arsimore në Evropë dhe botë.
- Fokusimi evropian dhe ndërkombëtar në fushat e Inxhinierisë së ndërtimit, përkatësisht Konstruksioneve, Gjeodezisë, Hidroteknikës, Inxhinierisë së Ambientit dhe Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore, që t'i sigurojmë studentit dhe stafit akademik lëvizshmëri dhe krahasueshmëri të standardeve në kualifikimet dhe diplomat e arritura. Përmes bashkëpunimit ndërkombëtar të integrohem plotësisht në zonën evropiane të arsimit të lartë.

### **3. METODOLOGJIA**

Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, në bazë të nenit 72 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, emëron grupin punues për hartimin e Planit të Veprimeve për FIN-it, me qëllim të zbatimit të planit strategjik të UP-së, për periudhën 2024-2028.

Ky grup do të ketë përgjegjësi në hartimin, dhe implementimin e planit të veprimeve duke pasur në fokus planin strategjik të Universitetit të Prishtinës.

Të gjitha aktivitetet zhvillimore të FIN-it do të udhëhiqen nga ky dokument i cili njëkohësisht do të jetë edhe tregues i performancës së strukturave menaxhuese të FIN-it mbi bazën e monitorimit dhe rishikimit vjetor të tij.

Grupi Punues përcakton shtyllat me prioritet për zhvillim të FIN-it duke punuar një draft inicial i cili më pastaj për kontribut shtesë i dërgohet menaxhmentit të Fakultetit, duke marrë për bazë të gjitha përgjegjësitë që nxjerr dokumenti për punën e tyre. Grupi punues përbëhet nga: Prof. Ass. Ymer Kuka, Prof. Ass. Besim Ajvazi, Prof. Ass. Zijadin Guri, Ass. Burbuqe Shatri, Ass. Vlerë Krasniqi, Ass. Premton Thaqi, Ass. Venera Hajdari, Ass. Labeat Misini, Ass. Guxim Rrudhani.

## 4. ANALIZË E GJENDJES AKTUALE

### 4.1. Struktura organizative e FIN-it

Struktura organizative e FIN-it është paraqitur në organogramin në vijim, ku mund të shihen ndërlidhjet në mes të stafit menaxhues dhe njërive të ndryshme që funksionojnë brenda fakultetit.





Figura 1. Organogrami i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit

### 4.2. Programet e Studimit

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit ka një gamë të gjerë të programeve të studimeve themelore (Baçelor) dhe të ciklit të dytë të studimeve (Master).

#### Programi i studimeve Baçelor – BSc

Gjatë programit të studimeve të ciklit të studimeve themelore (Baçelor), studentët marrin njohuri themelore në fushat e tyre të studimit dhe përgatiten për të ndërtuar një bazë të qëndrueshme të dijes dhe aftësive inxhinierike.



*Figura 2. Programet e studimit - Baçelor, FIN*

Këto janë programet e studimeve të ofruara në katër departamente të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në programin Baçelor (BSc):

#### **Departamenti i Konstruksioneve**

- Ky program ofron një kualifikim themelor në inxhinieri të ndërtimit, duke përfshirë të gjitha aspektet e ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës.

#### **Departamenti i Hidroteknikës**

- Ky program përgatit inxhinierë për të projektuar dhe menaxhuar burimet dhe infrastrukturën e ujit, përfshirë objektet hidroteknike, furnizimin me ujë, dhe kanalizimet.

#### **Departamenti i Gjeodezisë**

- Ky program përgatit inxhinierë gjeodetë të specializuar në matjet dhe hartografim gjeodetik, si dhe GIS-it.

#### **Departamenti i Inxhinierisë së Ambientit**

- Ky program përgatit inxhinierë të specializuar në menaxhimin e mjedisit dhe të mbrojturit e burimeve natyrore.

#### **Programi i studimeve Master – MSc**

Gjatë programit të studimeve Master, studentët mund të specializohen më shumë dhe zhvillojnë njohuri të thella dhe aftësi të avancuara në fushat e tyre të interesit.




Figura 3. Programet e studimit - Master, FIN

Këto janë programet e studimeve të ofruara në tri departamente të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në programin Master (MSc):

#### **Departamenti i Konstruksioneve**

- Programi i masterit ofron një nivel të lartë të specializimit në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, duke lejuar studentët të zhvillojnë njohuri dhe aftësi të thella.

#### **Departamenti i Hidroteknikës**

- Programi i masterit lejon studentët të thellojnë njohuritë e tyre në fushën e inxhinierisë hidroteknike dhe të zhvillojnë ekspertizë në menaxhimin e burimeve të ujit.

#### **Departamenti i Gjeodezisë:**

- Programi i masterit ofron një nivel të lartë të ekspertizës në fushën e gjeodezisë dhe inxhinierisë gjeodezike dhe GIS-it.

#### **Programi MIRU-K:**

- Programi i masterit në Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore, i ofruar në gjuhën angleze, i zhvilluar bashkarisht nga FIN dhe Qeveria Zvicerane.

Këto programe të studimeve ofrohen në kuadër të deklaratës së Bolonjës dhe janë të akredituara. Studentët kanë mundësinë të fitojnë njohuri të thella dhe të përgatiten për sfidat në fushën e inxhinierisë dhe mjedisit në Kosovë dhe ndërkombëtarisht.

### **4.3. Infrastruktura dhe Burimet**

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit gjendet në pjesën jugore të Prishtinës me një sipërfaqje rreth prej 8.70 hektarë. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit zotëron godinën kryesore dhe godinën e laboratorit. Sipërfaqja e përgjithshme që i përket Fakultetit të Inxhinierisë së

Ndërtimit është rreth 8600 m<sup>2</sup>, duke përfshirë hapësirat në godinën kryesore dhe ato në godinën e laboratorit. Sipërfaqja e objektit kryesor, përafërsisht 5,156 m<sup>2</sup>, është e zënë nga hapësira të përbashkëta komunikimi (korridoret, shkallët, tualetet, biblioteka etj.), amfiteatrot, klasat, zyrat e profesorëve, zyrat e administratës, zyra IT, zyrat e menaxhimit dhe ambiente të tjera ndihmëse. Laboratorët kanë një sipërfaqe prej 3369 m<sup>2</sup>.

Hapësirat në godinën kryesore të FIN, të cilat i përkasin FIN nga ndarja proporcionale me dy fakultetet e tjera (FIN dhe FIM) janë:

Niveli nr. 300 përfshinë klasat, zyrat e administratës së FIN ku zhvillohet aktiviteti për shërbimin e studentëve, zyra e IT, korridoret, shkallët, tualetet etj.

Niveli nr. 400 përfshinë hapësirat e përbashkëta të fakulteteve - korridore të mëdha, nje sanitare, depo etj. Në këtë nivel ndodhet pjesa më e madhe e administratës së FIN-it, shërbimeve studentore, sekretarisë, zyrave drejtuese dhe amfiteatrove. Në këtë nivel ndodhet hyrja kryesore e ndërtesës; Niveli nr. 500 të godinës me klasa, zyra të profesorave, hapësira të përbashkëta komunikimi - korridore, tualete etj. Në këtë nivel të godinës ndodhet edhe biblioteka e fakulteteve; Niveli nr. 700 përfshinë zyrat e profesorave dhe ambientet e përbashkëta. Çdo profesor me kohë të plotë në FIN zotëron zyrën e tij/saj me të gjitha ambientet e brendshme të nevojshme (tavolinë, pajisjet e nevojshme të punës, kompjuter, printer, telefon). Çdo zyrë ka edhe ujë të instaluar.

Çdo klasë është e pajisur me projektor dhe mjete konkretizimi në shërbim të mësimdhënies. Si objektet laboratorike ashtu edhe pajisjet laboratorike janë pronë e Universitetit të Prishtinës. Vit pas viti UP-ja investon pjesërisht në riparimin dhe funksionalizimin e hapësirave të objektit. Serverët dhe programet kompjuterike në pronësi të FIN-it gjithashtu kanë një licencë për t'u përdorur. Në FIN ekzistojnë: serveri i bazës së të dhënave (që rezulton nga granti i projektit "InWaterSense") dhe serveri i departamentit të gjeodezisë. Disa nga softuerët në pronësi të FIN janë: softueri GIS, softueri për përpunimin e imazheve satelitore (Erdas Imagine) dhe softveri i përpunimit dhe analizës së të dhënave satelitore (TTC), softueri për modelimin e rrjedhës së ujit nëpër lumenj natyrorë dhe kanale të tjera (HEC RAS), softueri për analiza statistikore të të dhënave hidrologjike (HEC SSP), softueri për modelimin hidraulik të cilësisë së ujit për sistemet e shpërndarjes së ujit WaterCAD si dhe softuera tjerë si Sewer CAD, Flow Master, HBV, Mod FLOW, SWAT etj. Sipërfaqja e ndërtesës për një student është 4.18 m<sup>2</sup>.

Në bibliotekën e fakultetit ka një numër të mjaftueshëm vendesh si dhe një numër të konsiderueshëm librash dhe revistash në shqip dhe anglisht. Salla e leximit ka 180 vende.

## Instituti i FIN-it

Në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor shkencor është edhe Instituti në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me laboraret përkatëse si më poshtë.




Figura 4. Laboraret e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit

Laboratorët janë një pjesë thelbësore e institutit, të specializuar në këto fusha:

### 1) Laboratori i Materialeve

Ky laborator mund të përdoret për studimin e materialeve të përdorura në ndërtim, duke përfshirë tretjen, testimin e fortësisë, dhe performancën e tyre në kushte të ndryshme;

### 2) Laboratori i Konstruksioneve

Ky laborator mund të përdoret për studimin e strukturave ndërtimore dhe testimin e tyre në kushte të ndryshme;

### 3) Laboratori i Gjeomekanikës

Ky laborator mund të përdoret për studimin e stabilitetit të terrenit dhe projektimin e strukturave mbi to.

### 4) Laboratori i Gjeodezisë

Ky laborator mund të përdoret për matje me pajisjet më moderne gjeodezike.

### 5) Laboratori i Asfaltit

Ky laborator mund të përdoret në hulumtimin dhe testimin e materialeve të përdorura në konstruksionin rrugor, përfshirë asfaltin dhe materiale të tjera të lidhura me rrugët.

### 6) Laboratori i Hidroteknikës

Ky laborator mund të përdoret për eksperimente në fushën e hidroteknikës.

## **7) Laboratori i Ambientit**

Ky laborator mund të përdoret për hulumtime në fushën e mjedisit, duke përfshirë monitorimin e ndikimit të ndërtimeve në mjedisin përreth.

Laboratorët janë thelbësorë për trajnimin e studentëve në fushën e inxhinierisë së ndërtimit dhe për zhvillimin e hulumtimeve shkencore.

### **4.4. Cilësia dhe Akreditimi**

Sistemi i sigurimit të cilësisë në UP "Hasan Prishtina" përfshinë shumë nga trupat vendimarrëse dhe implementuese që asistojnë njësitë administrative dhe akademike për përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë në përputhje me Statutin e UP-së, udhëzimet administrative mbi vlerësimin e Institucioneve të Arsimit të lartë të Ministrisë së arsimit, shkencës dhe teknologjisë (MASHT) dhe standardet dhe udhëzimet e ENQA-s. Autoriteti më i lartë në strukturat raportuese të UP-së për menaxhimin e cilësisë është Senati i UP-së, kurse në nivelin qendror të Universitetit është Këshilli për Menaxhimin e cilësisë. Ky Këshill raporton direkt te Senati i Universitetit përmes Prorektorit për zhvillim të cilësisë.

Procedurat për vlerësimin institucional përfshijnë një varg hapash dhe procedurash që janë pjesë të këtij procesi i cili udhëhiqet nga Rektori i UP-së. Rektori më tej delegon përgjegjësitë te grupi punues i përbërë prej: Prorektorit për cilësi, Drejtorit të ZZHA, një përfaqësues nga këshilli i cilësisë, një koordinator i zhvillimit akademik (prej NjA), dy anëtarë të stafit, një përfaqësues i studentëve. Në kuadër të sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë zhvillohen vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi i jashtëm. Mekanizmat dhe instrumentet bazë të sigurimit të cilësisë në nivel institucional janë: komisioni i sigurimit të cilësisë, komisioni i studimeve, zyra e zhvillimit akademik në nivel universitar.

Profesorët, stafi dhe studentët nëpërmjet mësimdhënies dhe mësimnxënies, gjenerojnë njohuri dhe zhvillojnë politika, teknika dhe aftësi për të ndihmuar praktikuesit të menaxhojnë burimet e ndërtimit dhe mjedisit. Profesorët organizojnë mësimdhënie, provime dhe vlerësime të studentëve. Vetëvlerësimi i personelit akademik (arritjet shkencore dhe profesionale) dhe lënda; vlerësimi i performancës së personelit akademik; Monitorimi i ecurisë së procesit mësimor dhe zbatimi i kurrikulës (leksione, ushtrime, provime) nga drejtuesit dhe diskutimet ndërmjet drejtuesit të departamentit dhe studentëve shtyjnë vazhdimisht përmirësimin e cilësisë në FIN.



I gjithë sistemi për sigurimin e jashtëm të cilësisë është i rregulluar me një Udhëzim Administrativ të nxjerrë nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës. Përmirësimi i vazhdueshëm në nivel programi ndodh bazuar në rekomandimet e ekspertëve të jashtëm për vlerësimin e programit.

Raportet me rezultatet e vlerësimeve u ofrohen bartësve të programeve për çdo lëndë. Këto raporte përfshijnë të dhëna të detajizuara për secilin kurs e të cilat ndihmojnë bartësit e programeve dhe Dekanin e njësisë akademike që të ndërmarrin strategji të planifikuara për avancimin e vazhdueshëm të programit. Po ashtu, bashkëpunimi me punëdhënësit ndihmon për të parë se sa janë realizuar objektivat e programit.

Në kuadër të Fakulteti të Inxhinierisë së Ndërtimit zyra e cilësisë bënë vlerësimin dhe raportimin mbi gjendjen e programit në baza vjetore. Në vlerësim përfshihen të gjitha palët e interesit duke përfshirë stafin akademik dhe administrativ të Fakultetit, sipas nevojës edhe ekspertë të jashtëm dhe përfaqësues të komunitetit të Bizneseve përmes Bordit Industrial, i cili është shumë aktiv në FIN. Kjo edhe shërben si një bazë për rishikim të programit, me ndihmën e profesionistëve të të gjitha fushave.

## **5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE**

Kjo strategji ka disa objektiva strategjike, në linjë me Planin Strategjik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” 2023 – 2025, të ndara tutje në objektiva dhe aktivitete të veçanta.

### **5.1.Objektivi Strategjik 1: Ngritja e Cilësisë në Mësimdhënie dhe Mësimnxënie**

Organizimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies përbën shtyllën kryesore të institucionit rreth së cilës mbështeten zhvillimet e aktiviteteve tjera shkencore, kërkimore për arritjen e objektivave të përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit.

Mekanizmat e mësimdhënies të cilat zbatohen në institucion janë bashkëkohore duke pasur profesorë të moshës së re të cilët reflektojnë kreativitet gjatë mësimin, përvojës të madhe profesionale të profesorëve si dhe grada shkencore të cilat sigurojnë rezultate të kënaqshme në zbërthimin e fenomeneve shkencore.

**Objektivi strategjik 1: Ngritja e Cilësisë në Mësimdhënie dhe Mësimnxënie** parasheh disa objektiva të veçanta si në vijim:

<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 1</b>	<b>Ngritja e Cilësisë në Mësimdhënie dhe Mësimnxënie</b>
<b>Objektivi i veçantë 1.1.</b>	Inkurajimi i ekselencës në mësimdhënie me metoda të reja.
<b>Objektivi i veçantë 1.2.</b>	Rishikimi dhe avancimi i programeve të studimit.
<b>Objektivi i veçantë 1.3.</b>	Zbatimi i standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe programeve të studimit.
<b>Objektivi i veçantë 1.4.</b>	Rritja e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve.
<b>Objektivi i veçantë 1.5.</b>	Rritja e performancës akademike.

Për të matur rritjen e ekselencës në mësimdhënie, do të përdoren tregues të qartë sikurse niveli i rritjes së numrit të të diplomuarve, rritja e pjesëmarrjes së studentëve në vlerësime të metodave të mësimdhënies, shtimi i kualifikimeve të stafit akademik, trajnimet e vazhdueshme të stafit akademik, zhvillimi i resurseve të brendshme për të ofruar trajnime mbi metodat e reja të mësimdhënies, mundësi më të mëdha për shkëmbim të përvojave përmes mobilitetit si dhe qasje në resurse të databazave ndërkombëtare, që ndërlidhen me sigurimin e cilësisë në mësimdhënie.

<b>Objektivi Strategjik 1: Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie</b>	
Objektivi i veçantë 1.1: Inkurajimi i ekselencës në mësimdhënie me metoda të reja	
<b>Treguesit</b>	<b>Vlera e synuar</b>
	<b>2025</b>
Norma më të larta të diplomimit	15% rritje nga numri aktual
Komente/vlerësime nga ana e studentëve	15% rritje nga numri aktual
Kualifikimet e stafit akademik	80% e stafit akademik kanë kualifikimet e duhura
Trajnimi i vazhdueshëm i stafit akademik	50% e personelit akademik ka marrë pjesë në trajnime në lidhje me mësimdhënien të paktën një herë me minimumin 6 orë
Të ofrohen trajnime të brendshme mbi metodologjitë e reja të mësimdhënies	10 grupe trajnimi

Qasje në shkëmbimin e përvojave	5 marrëveshje bashkëpunimi ndërkombëtare të reja
<b>Veprimet e planifikuara</b>	
1.1.1	Zhvillimi i kurseve të specializuara për stafin e mësimdhënies në teknikat dhe metodologjitë e reja të mësimdhënies
1.1.2	Inkurajimi i një qasjeje më aktive dhe praktike për mësimin përmes zhvillimit të aktiviteteve të mësimdhënies bazuar në projekte
1.1.3	Krijimi i një kulture të ndryshimit dhe inovacionit në mësimdhënie nëpërmjet konkurrencës dhe ndarjes së praktikave të mira mes mësimdhënësve
1.1.4	Ngritja e programeve dhe bursave për mësimdhënësit dhe studentët për të studiuar dhe praktikuar metodologjitë e reja të mësimdhënies në nivel ndërkombëtar

Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie synohet të arrihet edhe përmes rishikimit dhe avancimit të programeve të studimit. Ky objektivi i veçantë do të vlerësohet me shkallën e suksesit të studentëve në provime, niveli i diplomimit të studentëve, dhe numri i kandidatëve që aplikojnë për të studiuar në FIN. Në anën tjetër, strategjia synon që edhe shkalla e punësimit të studentëve pas diplomimit të rritet. Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie synohet të arrihet edhe përmes përdorimit të teknologjisë së re informative dhe materialeve moderne studimore.

<b>Objektivi Strategjik 1: Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie</b>	
Objektivi i veçantë 1.2: Rishikimi dhe avancimi i programeve të studimit	
<b>Treguesit</b>	<b>Vlera e synuar 2025</b>
Shkalla e suksesit të studentëve në provime	Rritja e kalueshmërisë prej <b>10%</b> më shumë
Shkalla e diplomimit të studentëve	<b>15%</b> rritje nga numri aktual
Përdorimi i pajisjeve të TI-së në mësimdhënie	Prezantimi i platformave të reja, prezantimi i kriterëve të reja të vlerësimit dhe detyrave të shtëpisë.
Rritja e numrit të kandidatëve për të studiuar në UP	<b>15%</b> rritje në numrin e aplikantëve
Materiale moderne studimore	Podkaste shtesë si material studimor, leksione shtesë të regjistruara paraprakisht
Shkalla e punësimit të studentëve pas diplomimit	<b>15%</b> rritje nga numri aktual

<b>Veprimet e planifikuara</b>	
1.2.1	Hartimi i kurrikulave efektive
1.2.2	Krijimi i programeve të reja të studimit me diploma të dyfishta dhe diploma të përbashkëta
1.2.3	Analiza e nevojave të tregut të punës dhe promovimi i bashkëpunimit me industrinë
1.2.4	Konsultime me studentët dhe mësuesit dhe monitorimi i performancës së studentëve
1.2.5	Promovimi i programit të studimit për të rritur ndërgjegjësimin dhe interesin e studentëve dhe punëdhënësve

Ngritja e cilësisë së mësimit dhe mësim nxënies synohet të arrihet edhe përmes zbatimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional. Standardet e vlerësimit do të kontribuojnë në sigurimin e cilësisë së brendshme. Kjo do të matet duke vlerësuar performancën akademike të studentëve, rritjen e përfshirjes së profesorëve ndërkombëtarë, zhvillimin e programeve të brendshme të trajnimit, mobilitetin në mësimit dhe rritjen e shkallës së kënaqshmërisë së studentëve me përmbajtjen e programit të studimit.

<b>Objektivi Strategjik 1: Ngritja e cilësisë në mësimit dhe mësimnxënie</b>	
Objektivi i veçantë 1.3: Zbatimi i standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe programeve të studimit	
<b>Treguesit</b>	<b>Vlera e synuar 2025</b>
Performanca akademike e studentëve	15% rritje e shkallës së diplomimit
Përfshirja e profesorëve ndërkombëtarë	15% rritje nga numri aktual
Programe për zhvillimin profesional të stafit akademik	Zhvillimi i dy programeve të brendshme të trajnimit
Performanca e stafit akademik në mësimit	10% rritje e shkallës së kënaqshmërisë me përmbajtjen e programit të studimit
<b>Veprimet e planifikuara</b>	
1.3.1	Identifikimi i standardeve të vlerësimit për sigurimin e cilësisë së brendshme
1.3.2	Zhvillimi i planeve të vlerësimit
1.3.3	Kryerja e vlerësimit dhe monitorimit të rregullt
1.3.4	Analiza dhe interpretimi i e të dhënave
1.3.5	Përmirësimi i performancës

Një ndër objektivat e veçanta në kuadër të objektivit të parë strategjik është edhe rritja e përfshirjes së studentëve në vendimmarrje. Strategjia synon edhe rritjen e angazhimit të FIN-it për të ndihmuar studentët të gjejnë punë praktike.

**Objektivi Strategjik 1: Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie****Objektivi i veçantë 1.4: Rritja e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve**

<b>Treguesit</b>	<b>Vlera e synuar 2025</b>
Investime për organizatat studentore	20% më shumë të numrit të aktiviteteve të organizuara nga studentët
Rritja e numrit të ngjarjeve nga ana e alumnit	3 ngjarje në vit
Asistimi i studentëve të gjejnë punë praktike	20% më shumë i numrit të studentëve që aplikojnë për punë praktike
<b>Veprimet e planifikuara</b>	
1.4.1	Promovimin e të nxënit bashkëpunues dhe ofrimin e mundësive për studentët që të përfshihen në kërkim
1.4.2	Përfshirja e studentëve në sigurimin e cilësisë
1.4.3	Përmirësimi i mirëqenies emocionale të studentëve përmes themelimit të Qendrës Këshilluese
1.4.4	Krijimi i klubeve të interesit që mund të ndihmojnë në nxitjen e angazhimit dhe krijimin e lidhjeve me studentët si dhe organizimi i aktiviteteve sociale dhe kulturore
1.4.5	Mundësimi i punës vullnetare që mund të ndihmojnë në rritjen e ndjeshmërisë sociale dhe në zhvillimin e aftësive të ndryshme

Rritja e performancës akademike ndikon drejtëpërdrejtë në ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Për më tepër, ky objektivi strategjik synon që të rrisë edhe nivelin e punës në grupe dhe diskutimeve në ligjërata. Ndër veprimet e planifikuara është edhe njohja dhe shpërblimi i përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkime.

**Objektivi Strategjik 1: Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie****Objektivi i veçantë 1.5: Rritja e performancës akademike**

<b>Treguesit</b>	<b>Vlera e synuar 2025</b>
Metodat e vlerësimit mbështesin të mësuarit	Prezantimi i metodave të reja të vlerësimit,
Puna në grupe dhe diskutimet në ligjërata	20% numër më i madh i punës në grupe
<b>Veprimet e planifikuara</b>	
1.5.1	Krijimi i sistemeve efektive të vlerësimit
1.5.2	Promovimi i integritetit akademik
1.5.3	Njohja dhe shpërblimi i përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkime
1.5.4	Investimi në infrastrukturë dhe burime
1.5.5	Përqendrimi në programet e specializuara

## 5.2.Objektivi Strategjik 2: Avancimi i Shkencës, Inovacionit dhe Ndërlidhja me Tregun e Punës

Ndër qëllimet kryesore të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN) është përforcimi i pozicionit si fakultet i orientuar në shkencë dhe hulumtim së bashku me ngritjen e qendrave të ekselencës (në disiplina relevante) dhe rritjen e njohjes ndërkombëtare e zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar me universitetet dhe institucionet në mbarë botën.

Objektivat e veçanta janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 2</b>	<b>Përmirësimi i pozicionit dhe rolit të FIN në skenën ndërkombëtare</b>
<b>Objektivi i veçantë 2.1.</b>	Rritja e rezultateve kërkimore –shkencore/artistike të stafit akademik në revista konkurruese të pranuar ndërkombëtarisht në fushën e tyre.
<b>Objektivi i veçantë 2.2.</b>	Sigurimi i zhvillimit profesional dhe mbështetjes në metodologjinë e hulumtimit, analiza statistikore, shkrimit për revista, ditarë dhe kostot e publikimit sipas nevojës.
<b>Objektivi i veçantë 2.3.</b>	Rritja e mundësive për realizimin e punëve dhe shërbimeve, që janë burim i të hyrave të universitetit.
<b>Objektivi i veçantë 2.4.</b>	Krijimi i kushteve për aktivitete shkencore në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare.

Aktivitetet e planifikuara për arritjen e secilës objektivë të veçantë, dhe rrjedhimisht arritjen e objektivës strategjike janë shfaqur në tabelat vijuese.

<b>Objektivi Strategjik 2: Avancimi i shkencës, inovacionit dhe ndërlidhja me tregun e punës</b>	
Objektivi I veçantë 2.1: Rritja e rezultateve kërkimore –shkencore/artistike të stafit akademik në revista konkurruese të pranuar ndërkombëtarisht në fushën e tyre.	
<b>Treguesit</b>	<b>Vlera e Synuar 2028</b>
Ekzistenca e grupeve kërkimore	Të paktën <b>4</b> grupe
Studime/publikime shkencore me partnerë ndërkombëtarë	Të paktën <b>3</b> studime të përbashkëta në vit
Konferenca të organizuara	Të paktën <b>3</b> deri në përfundim të periudhës
Pajisje të reja në laboratore	<b>10%</b> rritje nga numri aktual
<b>Veprimet e Planifikuara</b>	

2.1.1.	Raportimi në baza vjetore për rezultatet e arritura dhe masat obligative të ndërmarra.
2.1.2.	Promovimi I kërkimeve shkencore për stafin akademik në revista të mirëfillta shkencore dhe platformë kredibile.
2.1.3.	Krijimi I grupeve kërkimore shkencore në kuadër të FIN.
2.1.4.	Inkurajimi I përfshirjes së kapaciteteve ndërkombëtare në kërkime shkencore.
2.1.5.	Organizimi i konferencave dhe seminareve kombëtare dhe ndërkombëtare
2.1.6.	Informimi i profesionistëve për rezultatet e kërkimit përmes botimit të tyre në revista shkencore dhe profesionale, si dhe duke organizuar dhe sponsorizuar tubime shkencore dhe profesionale.
2.1.7.	Zhvillimin, modernizimin dhe certifikimin e laboratorëve.

Angazhimi i palëve të interesuara është një tjetër aspekt i rëndësishëm i procesit të vendimmarrjes së çdo institucioni. Duke përfshirë aktorë të ndryshëm si studentët, fakultetin, punëdhënësit, të diplomuarit dhe komunitetin lokal, në proceset e vendimmarrjes dhe duke kërkuar komente, institucioni mund të përfitojë nga këndvështrimet dhe njohuritë e tyre të ndryshme, të cilat mund të kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të tij.

### **Objektivi Strategjik 2: Avancimi i shkencës, inovacionit dhe ndërlidhja me tregun e punës**

Objektivi I veçantë 2.2: Sigurimi i zhvillimit profesional dhe mbështetjes në metodologjinë e hulumtimit, analiza statistikore, shkrimit për revista, ditarë dhe kostot e publikimit sipas nevojës.

<b>Treguesit</b>		<b>Vlera e Synuar 2028</b>
Numri i teksteve universitare		10% rritje nga numri aktual
Numri i kurseve elektronike		10% rritje nga numri aktual
Numri i titujve në bibliotekë		20% rritje nga numri aktual
Aksesi në baza elektronike botërore		Të paktën 2 baza elektronike
<b>Veprimet e Planifikuara</b>		
2.2.1.	Stimuj për botimin e teksteve universitare.	
2.2.2.	Stimuj për zhvillimin e kurseve elektronike.	
2.2.3.	Integrimin e mësimave mbi etikën dhe përgjegjësinë sociale në të gjithë kurrikulën. Kjo mund të përfshijë përfshirjen e diskutimeve mbi implikimet etike të temave të ndryshme brenda një lënde ose kushtimin e një kursi të tërë studimit të etikës dhe përgjegjësisë sociale.	
2.2.4.	Zgjerimi i koleksionit të bibliotekës.	
2.2.5.	Trajnimi i stafit për aplikime në grante kërkimore.	
2.2.6.	Implementimi i softuerit antiplagjiaturë.	
2.2.7.	Zhvillimi i aksesit në bazat e të dhënave elektronike botërore.	

Si objektive shumë e rëndësishme që kontribon në zhvillimin shkencor dhe profesional të kuadrove të dala nga FIN është edhe pjesëmarrja aktive në realizimin e projekteve zhvillimore të inxhinierisë së ndërtimit me ndikim më të gjerë shoqëror, rrjedhimisht ndërlidhja me tregun e punës.

<b>Objektivi Strategjik 2: Avancimi i shkencës, inovacionit dhe ndërlidhja me tregun e punës</b>	
Objektivi I veçantë 2.3: Rritja e mundësive për realizimin e punëve dhe shërbimeve, që janë burim i të hyrave të universitetit.	
<b>Treguesit</b>	<b>Vlera e Synuar 2028</b>
Aplikimi në projekte shkencore	Të paktën <b>2</b> aplikime në vit
Aplikimi në projekte industriale/teknologjike	Të paktën <b>2</b> aplikime në vit
Memorandume bashkëpunimi	Të paktën <b>2</b> kompani publike/biznese në vit
<b>Veprimet e Planifikuara</b>	
2.3.1.	Bashkëpunimi me departamentet e kërkimit dhe zhvillimit në sektorin e biznesit me qëllim të aplikimit të rezultateve të kërkimit.
2.3.2.	Lidhjen me kompanitë publike.
2.3.3.	Ofrimi i shërbimeve shumë profesionale në procesin e studimit dhe projektit.
2.3.4.	Bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse.
2.3.5.	Përfshirja e stafit të fakultetit në shoqatat profesionale.
2.3.6.	Gjetja e mundësive për pjesëmarrje në projekte shkencore vendore dhe ndërkombëtare (thirrjet për projekte nga UP, MASHT, FULBRIGHT, HORIZON EUROPE, ERASMUS+, CEEPUS, HERAS, EPA, DAAD, GIZ, ADA, subjekte të ndryshme financuese, etj.)
2.3.7.	Përmirësimi i personelit, kërkesave teknike dhe formale për pjesëmarrje në projekte shumë profesionale.

Për të arritur nivelin e cilësisë dhe nagazhimit që pretendon FIN-i, duhet krijuar kushtet për bashkëpunime, hulumtime dhe zhvillim të materialeve.

<b>Objektivi Strategjik 2: Avancimi i shkencës, inovacionit dhe ndërlidhja me tregun e punës</b>	
Objektivi I veçantë 2.4: Krijimi i kushteve për aktivitete shkencore në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare.	
<b>Treguesit</b>	<b>Vlera e Synuar 2028</b>
Kërkime shkencore të përbashkëta me universitete ndërkombëtare	<b>20%</b> rritje nga numri aktual



Numri i stafit akademik që ligjëron për të paktën një javë jashtë vendit	20% rritje nga numri aktual
Numri i stafit akademik që merr pjesë në trajnime, për të paktën një javë jashtë vendit	30% rritje nga numri aktual
Ekzistenca e qendrave virtuale	Të paktën 2 qendra
<b>Veprimet/Aktivitetet e Planifikuara</b>	
2.4.1.	Promovimi dhe pjesëmarrja në krijimin e qendrave kërkimore në bashkëpunim me sektorin e biznesit.
2.4.2.	Stimuj për zhvillimin e kurseve elektronike.
2.4.3.	Lidhja e kapaciteteve kërkimore në Kosovë dhe jashtë saj duke krijuar një rrjet studiuesish (qendra virtuale).
2.4.4.	Përmirësimi i personelit, kërkesave teknike dhe formale për pjesëmarrje në projekte shumë profesionale.
2.4.5.	Rritja e mobilitetit të studentëve, mësuesve dhe stafit administrativ.

### 5.3.Objektivi Strategjik 3: Përmirësimi i Pozicionit dhe Rolit të FIN në Skenën Ndërkombëtare

Objektivi strategjik 3 synon avansimin e mëtutjeshëm të FIN në arritjen e marrëveshjeve të reja dhe krijimin e bashkëpunimeve me institucionet ndërkombëtare. Kjo do të arrihet duke rritur mundësitë e studimit për studentët, bashkëpunimin me studiues dhe duke angazhuar profesorë ndërkombëtar, angazhimin në bashkëpunimet akademike dhe projektet ndërkombëtare, zgjerimin e mundësive për studentët dhe stafin e FIN-it për të kryer studime dhe trajnime jashtë vendit, si dhe përmes ligjëratave të hapura.

<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 3</b>	<b>Përmirësimi i pozicionit dhe rolit të FIN në skenën ndërkombëtare</b>
<b>Objektivi i veçantë 3.1.</b>	Rritja e numrit të studentëve dhe profesorëve ndërkombëtar
<b>Objektivi i veçantë 3.2.</b>	Bashkëpunimet akademike dhe projektet ndërkombëtare
<b>Objektivi i veçantë 3.3.</b>	Zgjerimi i mundësive për studentët dhe stafin e FIN-së për të kryer studime dhe trajnime jashtë vendit
<b>Objektivi i veçantë 3.4.</b>	Ligjëratat e hapura

Veprimet e planifikuara në kuadër të këtij objektivi strategjik janë rritja e numrit të profesorëve ndërkombëtar që angazhohen në mbajtjen e ligjëratave dhe ushtrimeve në FIN, rritja e numrit të studentëve ndërkombëtar që vijnë për të studiuar dhe rritja e numrit të studiuesve që bashkëpunojnë dhe kryejnë hulumtimet në FIN.

**Objektivi strategjik 3: Përmirësimi i pozicionit dhe rolit të FIN në skenën ndërkombëtare**

Objektivi i veçantë 3.1: Rritja e numrit të studentëve dhe profesorëve ndërkombëtar

<b>Treguesit</b>	<b>Vlera e synuar 2028</b>
Numri i profesorëve ndërkombëtar	20% rritje nga numri aktual
Numri i studentëve ndërkombëtar	20% rritje nga numri aktual
Numri i studiuësve ndërkombëtar	20% rritje nga numri aktual
<b>Veprimet e planifikuara</b>	
Krijimi i partneritetit me profesorë dhe institucione ndërkombëtare	
Ofrimi i kurseve dhe programeve akademike në gjuhë të huaj	
Metoda të reja marketingu dhe promovimi	

Objektivi strategjik për bashkëpunimet akademike dhe projektet ndërkombëtare është shumë i rëndësishëm për FIN. Për të arritur këtë është e rëndësishme të kryhen plane dhe strategji të qarta, të investohet në zhvillimin e kapaciteteve, dhe të monitorohet vazhdimisht progresi në drejtim të tyre. Gjithashtu, bashkëpunimi i vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtar në rritjen e numrit të projekteve të përbashkëta, publikimeve shkencore dhe konferencave janë thelbësore për arritjen e suksesit në këtë fushë.

**Objektivi strategjik 3: Përmirësimi i pozicionit dhe rolit të FIN në skenën ndërkombëtare**

Objektivi i veçantë 3.2: Bashkëpunimet akademike dhe projektet ndërkombëtare

<b>Treguesit</b>	<b>Vlera e synuar 2028</b>
Numri i projekteve ndërkombëtare	Të paktën 2 aplikime në vit
Studime/publikime shkencore	Të paktën 3 studime të përbashkëta në vit
Kërkime shkencore të përbashkëta me universitete ndërkombëtare	20% rritje nga numri aktual
Pjesëmarrja në konferenca shkencore ndërkombëtare	20% rritje nga numri aktual
<b>Veprimet e planifikuara</b>	
Krijimi i partneriteteve me universitet dhe institucione kërkimore ndërkombëtare	

Përkrahja e stafit për aplikim në projekte ndërkombëtare
Zhvillimi i takimeve dhe hulumtimeve me institucione ndërkombëtare
Krijimi i grupeve punuese për aplikime në projekte

Zgjerimi i mundësive për studentët dhe stafin e FIN-it për të kryer studime dhe trajnime jashtë vendit, synohet të arrihet përmes partneriteteve me universitete ndërkombëtare për programet e shkëmbimit (ERASMUS, CEEPUS, MEVLANA).

Brenda kësaj periudhe, strategjia synon që të rritet numri i studentëve që shkojnë për të paktën një semestër jashtë vendit, të rritet numri i stafit akademik që ligjëron për të paktën një javë jashtë vendit, të rritet numri i stafit akademik dhe administrativ që merr pjesë në trajnime, për të paktën një javë jashtë vendit.

<b>Objektivi strategjik 3: Përmirësimi i pozicionit dhe rolit të FIN në skenën ndërkombëtare</b>	
Objektivi i veçantë 3.3: Zgjerimi i mundësive për studentët dhe stafin e FIN për të kryer studime dhe trajnime jashtë vendit	
<b>Treguesit</b>	<b>Vlera e synuar 2028</b>
Numri i studentëve që shkojnë për të paktën një semestër jashtë vendit	40% rritje nga numri aktual
Numri i stafit akademik që ligjëron për të paktën një javë jashtë vendit	20% rritje nga numri aktual
Numri i stafit akademik që merr pjesë në trajnime, për të paktën një javë jashtë vendit	30% rritje nga numri aktual
Numri i stafit administrativ që merr pjesë në aktivitete për shkëmbim të stafit, që zgjasin të paktën një javë	30% rritje nga numri aktual
<b>Veprimet e planifikuara</b>	
Zhvillimi i partneriteteve me universitetet ndërkombëtare për programet e shkëmbimit (Erasmus, CEEPUS, MEVLANA, etj)	
Zhvillimi i takimeve dhe hulumtimeve me institucione ndërkombëtare	
Përkrahja e studentëve dhe stafit për studime dhe trajnime jashtë vendit	

Ligjëratat e hapura janë një mjet i rëndësishëm për të promovuar arsimin dhe ndarjen e njohurive. Ata japin çasje të lirë në njohuri dhe ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të individëve dhe komuniteteve. Përmes zbatimit të këtij objekti strategjik, FIN mund të kontribuojë në përhapjen e njohurive dhe në rritjen e ndërgjegjësimit në nivel global.

**Objektivi strategjik 3: Përmirësimi i pozicionit dhe rolit të FIN në skenën ndërkombëtare**

Objektivi i veçantë 3.4: Ligjëratat e hapura

<b>Treguesit</b>	<b>Vlera e synuar 2028</b>
Numri i ligjëruesve ndërkombëtar, për ligjëratat të hapura në FIN	30% rritje nga numri aktual
Numri i ligjëruesve vendor që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, për ligjëratat të hapura në FIN	20% rritje nga numri aktual
Profesionist nga fusha e biznesit	30% rritje nga numri aktual
<b>Veprimet e planifikuara</b>	
Ftesa për ligjëruesit ndërkombëtar nga fushat e inxhinierisë së ndërtimit.	
Organizimi i ngjarjeve që kanë për qëllim informimin dhe këshillimin e studentëve.	
Shpalosja mundësive dhe nevojave për tregun e punës.	

## **6. ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI**

Monitorimi dhe raportimi janë faktorë themelorë të zbatimit të strategjisë, progresit dhe përmbushjes së qëllimeve të Universitetit të Prishtinës (UP).

Këshilli i FIN-it do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e kësaj strategjie duke përfshirë:

- Këshilli i FIN-it emëron një komision për monitorimin, vlerësimin dhe implementimin e kësaj strategjie. Ky komision do të ketë përgjegjësinë për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të implementimit të strategjisë.
- Komisioni për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të strategjisë, në bashkëpunim me të gjitha strukturat relevante të FIN-it, në etapa të caktuara do të paraqesë raporte të rregullta mbi zbatimin e Planit të Veprimit dhe përparimin e arritur në realizimin e qëllimeve të strategjisë.
- Përcaktimi i treguesve të përshtatshëm për monitorimin e progresit është thelbësor. Këta tregues do të ndihmojnë në vlerësimin e nivelit të arritjes së objektivave dhe në identifikimin e çdo vështirësie ose sfide që ndodhin në rrugën drejt qëllimeve.
- Plani i Veprimit duhet të përditësohet dhe rishikohet çdo vit.

Pas përfundimit të zbatimit të strategjisë, është e rëndësishme zhvillimi i një vlerësimi të përgjithshëm që do të ndihmojë të shihet efekti dhe ndikimi i strategjisë në fuqizimin e FIN-it dhe në përgjithësi në përmbushjen e qëllimeve të Universitetit të Prishtinës (UP).

## **7. NDIKIMI BUXHETOR I STRATEGJISË**

Ndikimi buxhetor në zbatimin e strategjisë së Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit luan një rol kyç në arritjen e objektivave të caktuar në këtë strategji. Shumë planifikime mund të realizohen me buxhetin e paraparë për FIN nga institucioni qendror, por kërkohet edhe burime tjera financiare për të realizuar hapat e nevojshëm drejt qëllimeve të strategjisë. Rritja e të ardhurave të planifikuara përmes Institutit të FIN-it dhe donatorëve potencial do të kontribuojë në rritjen e numrit të studentëve, të zhvillojë programe të reja studimore ose të përmirësojë oferta ekzistuese. Me rritjen e të ardhurave do të fuqizojmë në rritjen e numrit të hulumtuesve shkencorë brenda FIN-it dhe fuqizim të njësisë tonë akademike në aspektin ndërkombëtar.

Partneritete dhe donacione, me organizata, biznese apo fakultete të tjera si rajonale ashtu edhe ndërkombëtare, si dhe për të zhvilluar marrëdhënie të mira me komunitetin dhe donatorët potencialë. Këto partneritete dhe donacione mund të ndihmojnë në financimin e projekteve të veçanta në sigurimin e burimeve afatgjatë.



**UNIVERSITETI I  
PRISHTINËS "HASAN  
PRISHTINA"**

**Prishtinë, 2023**